



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



Zhvillimet në Tregtinë e Jashtme për tremujorin e parë 2005 (Janar-Mars, 2005)

Gjatë periudhës Janar-Mars 2005, tregtia e mallrave të Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare vazhdoi të ruajë trendet pozitive.

Eksportet, të shprehura në dollarë amerikan, shënuan një vëllim prej 159.2 milionë, me një rritje prej 17% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2004. Megjithëse kjo është një rritje pozitive, në termat e dinamikës kohore, kjo periudhë shënon një rënie në ritmet e rritjes krahasuar me një vit më parë. Kështu, për të njëjtën periudhë krahasimore, në vitin 2004 ndaj vitit 2003, ritmi i rritjes së eksporteve ishte 26%. Kjo rënie në ritmet e rritjes i dedikohet një rënieje në ritmet e rritjes së eksporteve në gati të gjitha kategoritë e mallrave kryesore të eksportit, me përjashtim të eksporteve të prodhimeve të lëkurës (këpucë, etj).

Në një vështrim analitik në strukturën e mallrave të eksporteve, në kategoritë kryesore të mallrave me origjinë bujqësore dhe agroindustrisë, eksportet e produkteve vegjetale (që zënë 3.2% të totalit të eksporteve), u rritën me 10.4% (nga 47% që ishte ritmi i rritjes për vitin 2004 në raport me vitin 2003); eksportet e ushqimeve të përgatitura, pije dhe duhanit (3.6% e totalit të eksporteve) u rritën me 12.7%, nga 59% që ishte ritmi rritjes në vitin 2004 ndaj vitit 2003. Në eksportin e produkteve industriale, riekportet e industrisë së veshjeve (që zënë 35.8% të totalit të eksporteve) u rritën me vetëm 7.8%, nga një ritëm rritje prej 31.6% që ishte shënuar në vitin 2004 ndaj vitit 2003; eksporti i metaleve (12% e totalit të eksporteve) u rrit me vetëm 11.7%, nga 58% që ishte rritja në vitin 2004 ndaj vitit 2003.

Nga ana tjetër, **importet shënuan në vëllim prej 545.4 milionë USD, me një rritje prej 14%**, që është afërsisht e njëjtë me ritmet e rritjes së shënuar në të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Në termat e strukturës, të gjitha kategoritë e importeve shënuan rritje, me përjashtim të lëkurës së papërpunuar.

Deficiti tregtar për periudhën janar-mars 2005 shënoi 386 milionë USD, me një rritje prej 14% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2004.

Tabela 1: Importet dhe eksportet për periudhën Janar-Mars 2005

Në milionë USD

Muaji	Eksportet		Importet		Deficiti tregtar
	Në vlerë absolute	% ndaj të njëtës periudhë të vitit 2004	Në vlerë absolute	% ndaj të njëtës periudhë të vitit 2004	
Janar	49.97	17%	164.36	15%	114.39
Shkurt	50.47	6%	182.72	14%	132.24
Mars	58.73	26%	198.37	16%	139.64
Tremujori	159.17	17%	545.44	15%	386.27

Nga pikëpamja e gjeografisë së tregtisë, eksportet ruajtën një ritëm më të lartë rritjeje në vendet e rajonit, ku rritja ishte 27.6%, krahasuar me një rritje prej vetëm 15% në vendet e BE-së. Brenda vendeve të BE-së, ritmi i rritjes së eksporteve më i lartë ishte me Italinë, me 17.7% dhe vetëm 8.3% me Greqinë. Ndërsa tregtia me Gjermaninë shënoi rënie: eksportet drejt Gjermanisë shënuan një rënie me 18% dhe importet nga Gjermania ranë me 3.7%.

Table 2 Tregtia e jashtme sipas vendeve: Janar-Mars 2005

Në milionë USD

Vendet	Eksportet			Importet			Deficiti tregtar
	Në vlerë absolute	% ndaj të njëtës periudhë të vitit 2004	Në vlerë absolute	% of the total	% ndaj të njëtës periudhë të vitit 2004		
Vendet e BE-se	146.67	92.14	15.17	351.43	64.43	10.66	204.76
Gjermania	5.52	3.47	-18.11	23.72	4.35	-3.69	18.20
Greqia	19.63	12.33	8.28	99.79	18.30	6.92	80.16
Italia	119.14	74.85	17.76	178.75	32.77	8.06	59.61
Austria	0.23	0.15	-11.59	12.53	2.30	94.97	12.30
Mbretëria e Bashkuar	0.47	0.30	1182.07	4.76	0.87	281.98	4.28
Vendet e tjera të BE-se	1.68	1.05		31.89	5.85		30.21
Vendet e Europës Juglindore	7.68	4.82	27.61	42.71	7.83	42.45	35.03
Kosova	4.21	2.65	22.89	1.24	0.23	62.20	-2.97
Maqedonia	1.99	1.25	103.14	7.38	1.35	31.97	5.39
Serbia & Mali i Zi	0.74	0.46	-8.25	5.97	1.10	-18.05	5.24
Kroacia	0.01	0.00	-96.63	8.32	1.53	44.41	8.31
Bullgaria	0.42	0.26	-23.60	15.05	2.76	74.99	14.64
Rumania	0.17	0.11	456.13	4.39	0.80	133.65	4.22
Bosnja dhe Hercegovina	0.15	0.09	146.23	0.35	0.07	284.41	0.20
SHBA	1.27	0.79	55.47	4.04	0.74	-39.10	2.78
Turqia	2.57	1.61	103.34	43.18	7.92	25.40	40.61
Vendet e tjera	0.99	0.62		104.08	19.08		103.09
TOTAL	159.17	100		545.44	100		386.27

Me vendet e rajonit eksportet drejt drejt Kosovës u rritën me rreth 23% dhe drejt Maqedonisë u dyfishuan. Eksportet drejt vendeve të tjera të rajonit vazhdojnë të mbeten në nivele modeste. Ndërkohë, importet nga rajoni u rritën me një ritëm më të shpejtë se eksportet. Në raport me të njëjtën periudhë të vitit 2004 ato u rritën me 42.5%. Me përjashtim të një rënieje të importeve nga Serbia dhe Mali i Zi, importet nga të gjithë vendet e tjera janë rritur ndjeshëm. Në veçanti importet nga Bullgaria, që përbën tregun kryesor të importeve tona nga vendet e rajonit, u rritën me 75% krahasuar me një vit më parë.

Importet e veshjeve nga Kina, për shkak të përfundimit të regjimit tregtar të kuotave në kuadër të Marrëveshjes Multifibër, nuk kanë njohur ndonjë zhvillim të veçantë. Importet janë rritur me norma normale, me respektivisht 3.6 dhe 17% për klasën 61 dhe 62 të Sistemit të Harmonizuar.

Tabela 3: Importet dhe eksportet gjatë periudhës Janar - Mars 2005

Seksioni sipas kodit të Sistemit të Harmonizuar (SH)	Përshkrimi i Seksionit	Eksporte (F.O.B)			Importe (C.I.F)			<i>Në milionë USD</i>
		Vlera	Volumi ndaj totalit	Rritja në % ndaj të njëjtës periudhë 2004	Vlera	Volumi ndaj totalit	Rritja në % ndaj të njëjtës periudhë 2004	
1	Kafshët e gjalla, produkte me origjinë prej kafshëve	0.71	0.45	184.23	18.66	3.42	24.88	
2	Produkte vegjetale	5.04	3.17	10.43	43.04	7.89	7.04	
3	Vajra dhe dhjamra prej kafshëve apo vegjetale, dhe produktet e ndarjes së tyre	0.07	0.04	266.32	10.11	1.85	7.28	
4	Ushqimet e përgatitura, pijet, alkoolet dhe uthullat, duhanet dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	5.80	3.64	12.71	39.98	7.33	10.07	
5	Produktet minerale	1.96	1.23	-47.97	57.89	10.61	23.39	
6	Produktet e industrive kimike apo të industrive të lidhjeve	1.05	0.66	165.11	37.38	6.85	13.32	
7	Plastika, goma dhe produktet e tyre	0.62	0.39	142.62	17.87	3.28	39.40	
8	Lëkura dhe prodhimet e saj	3.33	2.09	-0.95	12.90	2.37	-15.62	
9	Druri dhe Lënda e drurit	2.87	1.80	35.03	6.92	1.27	29.92	
10	Druri i i pëpunuar, letra dhe nënproduktet e saj	2.92	1.83	114.45	10.43	1.91	18.15	
11	Tekstilet dhe artikujt tekstile	56.93	35.76	7.79	57.90	10.62	3.74	
12	Veshjet e këmbëve, veshjet e kokës, çadrat	47.25	29.68	22.01	16.61	3.05	2.51	
13	Artikuj prej guri, allcie, cementoje, asbesti,	0.65	0.41	39.79	19.80	3.63	36.09	
14	Perlat natyrore apo të kultivuara, gurët e çmuar apo gjysëm të çmuar	0.38	0.24	127.67	0.28	0.05	3.71	

15	Metalet baze dhe artikujt me metale bazë	19.11	12.00	11.64	55.26	10.13	36.01
16	Makineritë dhe pajisjet mekanike, pajisje elektrike, pjesët e tyre, regjistruesit dhe riprodhuesit e tingullit	6.61	4.15	118.22	88.68	16.26	15.75
17	Mjetet e e transportit rrugor, ajror, detar dhe pajisjet shoqëruese të transportit	0.35	0.22	1.97	31.38	5.75	4.26
18		0.29	0.18	84.75	9.38	1.72	20.50
	Instrumentat dhe aparatet optike						
19	Armët dhe municionet, pjesët e tyre	0.10	0.06	1233.91	0.35	0.06	153.19
20	Artikuj të ndryshëm të prodhuar	3.15	1.98	39.06	10.59	1.94	6.53
21	Veprat e artit, copat e mbledhura nga koleksionet antike	0.00	0.00	-99.88	0.02	0.00	-10.82
TOTAL:		159.17	100.00		545.44	100	

Burimi: Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, ACIT

Tabela 4: Importet dhe eksportet e produkteve bujqësore gjatë periudhës janar-shkurt 2005

Seksioni sipas kodit të Sistemit të Harmonizuar (SH)	Përshkrimi i Seksionit	Eksporte			Importe			<i>Në mijë USD</i>
		Vlera	Volumi ndaj totalit	Rritja në % ndaj të njëjtës periudhë 2004	Vlera	Volumi ndaj totalit	Rritja në % ndaj të njëjtës periudhë 2004	
1	Kafshë të gjalla	0.01	0.00		2.99	0.55	244.11	
2	Mish dhe të brendshme të ngrënëshme	-	0.00			2.21	22.07	
3	Peshk dhe krustace, molusqe dhe intervertebrorë të tjerë ujorë	0.29	0.18	138.10	12.07	0.13	-64.28	
4	Produkte bulmeti, vezë pule, mjaltë natyral ...	0.34	0.22	166.73	0.69	0.53	33.07	
5	Produkte me origjinë prej kafshëve të paspecifikuar apo përfshirë diku tjetër	0.07	0.05	#DIV/0!	2.87	0.01	-56.46	
					0.04			

6	Pemë për mbjellje dhe bimë të tjera; bulbe, rrënjë dhe të ngjashme me to; lule të këputura dhe gjethe dekorative	0.19	0.12	153.55	0.94	0.17	63.37
7	Perime të ngrënshme dhe rrënjët e zhardokët përkatës	0.22	0.14	156.38	7.72	1.42	-10.94
8	Fruta dhe fara të ngrënshme;lëkura agrumesh ose pjepri	0.00	0.00	111.66	14.86	2.72	47.47
9	Kafe, çaj, mate dhe erëza	0.35	0.22	56.17	2.03	0.37	16.15
10	Drithëra	0.00	0.00	22.23	13.92	2.55	3.20
11	Produkte të industrisë së bluarjes; malt; niseshte; insulinë; gluten gruri	0.00	0.00	-98.44	2.66	0.49	-44.45
12	Fara dhe fruta vajore dhe fruta; kokrra të ndryshme, fara dhe fruta; bimë industriale apo mjekësore; kashtë dhe foragjere	4.24	2.66	14.23	0.90	0.16	6.38
13	gomë, rrëshirë dhe lengje të tjera vegjetale e ekstrakte	0.03	0.02	-85.02	0.01	0.00	-59.27
14	Produkte vegjetale të paspecifikuara apo përfshira diku tjetër	0.00	0.00	#DIV/0!	0.01	0.00	197.23
15	Yndyrna me origjine nga kafshët apo vegjetale dhe vajra ...	0.07	0.04	266.32	10.11	1.85	7.28
16	Përgatitje prej mishi, peshku apo krustacesh, molusqesh ose intervertebrorësh të tjerë ujorë	4.66	2.93	30.36	3.21	0.59	217.43
17	Sheqer dhe embëlsira	0.00	0.00	-84.71	3.59	0.66	-37.44
18	Kakao dhe përgatitje prej saj	0.01	0.01	#DIV/0!	1.75	0.32	21.94
19	Përgatitje prej drithërave, miellit, niseshtesë ose qumështit; artikuj poçerie	0.02	0.01	185.89	8.94	1.64	16.56
20	Përgatitje prej perimeve, frutave, farave ose pjesëve të tjera të bimëve	0.35	0.22	31.46	3.25	0.60	-9.23
21	Përgatitje të ngrënshme të ndryshme	-	0.00	-100.00	3.84	0.70	41.44
22	Pije, pije alkolike dhe uthull	0.64	0.40	-40.52	5.53	1.01	7.33

23	Mbetje nga industritë e ushqimore; ushqim i përgatitur për kafshë	0.03	0.02	-77.85	1.30	0.24	184.55
24	Duhan dhe zëvendësues të përpunuar të tij	0.10	0.06	3.55	8.57	1.57	-0.02
TOTAL		11.62	7.30	46.21	112	20.49	17.17
<i>Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ACIT</i>							